



PLANI I VEPRIMIT RINOR LOKAL

2023 – 2025

**Komuna e Gjakovës
Prill 2022**

- **PËRMBAJTJA**

PARATHËNIE	4
HYRJE	5
BAZA LIGJORE	6
QËLLIMI DHE KOMPONENTAT KRYESORE TË PLANIT	7
VLERËSIMI I NEVOJAVE PRIORITARE PËR RININË GJAKOVARE	11
MONITORIMI DHE VLERËSIMI I IMPLEMENTIMIT / ZBATIMIT	12
MATRIKSI I PLANIT TË VEPRIMIT RINOR LOKAL 2015-2017	15

- **SHKURTESAT:**

KK	Kuvendi Komunal Gjakovë
DKRS	Drejtoria Komunale për Kulturë, Rini dhe Sport
DKA	Drejtoria Komunale për Arsim
DKSHMS	Drejtoria Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
KVRL	Këshilli i Veprimit Rinor Lokal
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
OSCE	Organisation for Security and Cooperation in Europe
GWYA	George Williams Youth Association in Kosovo
BSC	Bethany Christian Service
RAGJ	Rinia Aktive e Gjakovës
Roma in Action-	
JIC	Jakova invocation Center
Bone Vet-	
Hendikos	
BTR	Besimi për transformim rural
Activisem Roots	

• PARATHËNIE

- Plani i Veprimit Rinor Lokal - Gjakovë, nënkupton politikën lokale për rini për periudhën tri vjeçare, respektivisht për vitet 2023 - 2025. Kjo është një strategji gjithëpërfshirëse dhe Plan për të rinjtë e Gjakovës i hartuar në bazë të nevojave më prioritare të dalura nga organizatat rinore lokale. Ky është një dokument i rëndësishëm për Komunën e Gjakovës dhe Rininë e saj, sepse parashtrohet një mori aktivitetesh që mund të implementohen bashkërisht nga Komuna, OJQ-të, Këshilli i Veprimit Rinor Lokal (KVRL), Qendra rinore si dhe është dokument që i paraqitet të gjithë donatorëve potencial të interesuar që të investojnë në sektorin rinor të Komunës së Gjakovës, ku secili donator mund të shpreh interesim sipas prioriteteve të veta programore, që janë të përfshira në këtë Plan i cili aprovohet formalisht nga Asambleja Komunale e Komunës së Gjakovës.
- Ky plan përcakton mënyrat e qasjes së politikave rinore Lokale ndaj të rinjëve në bazë të nevojave të të rinjëve në qytetin e Gjakovës. Plani i Veprimit Rinor Lokal Gjakovë iu adresohet të rinjëve të moshave 15 - 24 vjeç dhe çdo kush që i takon kësaj grup moshe do të përfitoj në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, pa dallim moshe, race, gjinie, religjioni dhe orientimi seksual. Plani i Veprimit Rinor Lokal Gjakovë promovon bashkëpunimin ndërmjet organizatave rinore, grupeve jo formale dhe qeverisë Lokale dhe në të njëjtën kohë ndërlikohet politikat ndër-sektoriale në mes të drejtorive të ndryshme pranë Komunës së Gjakovës, që ndërlikohet me të rinjtë në fushën e politikave dhe programeve rinore.

HYRJE

Komuna e Gjakovës ka një pozitë shumë të mirë gjeografike dhe shtrihet në pjesën jugë lindore të Rrafshit të Dukagjinit, përkatësisht në pjesën jugperëndimore të Kosovës, e cila është pjesë përbërëse e regjionit qendror të Gadishullit Ballkanik dhe pjesës Juglindore të Evropës. Shtrihet në një sipërfaqe prej 586 km² dhe në lartësi mbidetare prej 365 m, me rreth 100,000 banorë. Ka tokën pjellore, fushat, malet si dhe bjeshket e larta që e rrethojnë në Jugperëndim. Është e pasur me lumenjë si “Ereniku”, “Krena”, “Llukaci”, “Drini i Bardhë” dhe ca lumenjë të vegjel por të rëndësishëm.

Komuna e Gjakovës kufizohet me Republikën e Shqipërisë me të cilën ka dy pika kufitare, atë të Qafës së Prushit në Jug - ku lidhet me Regjionin e Hasit (Letaj, Krum, Kukës, etj.) dhe atë të Qafës së Morinës në perëndim - që lidhet Malësin e Gjakovës (Tropojë, Bajram Curr, etj.). Komuna e Gjakovës kufizohet edhe me Komunat e: Prizrenit, Pejës, Rahovecit, Malishevës, Klinës, Junikut dhe Deçanit.

Historikisht, Komuna e Gjakovës është njohur për potencialin Industrial prodhues, trashëgiminë kulturore, cilësinë në Arsim, si dhe potencialin artistiko-muzikor, duke ofruar të gjithë infrastrukturën e nevojshme për aktivitete të ndryshme dhe mundësi zhvillimi.

Komuna e Gjakovës posedon me 40 Shkolla Fillore, 8 Shkolla të Mesme, Universitetin “Fehmi Agani”, si dhe me 37 Organizata Rinore aktive, duke ofruar mundësi të shumë aktiviteteve dhe zhvillimeve rekreative, arsimore, kulturore, për të rinjtë e Komunës së Gjakovës.

Gjithashtu në Komunë e Gjakovës, për herë të parë në Kosovë, është krijuar hapësira kreative teknologjike “Bone Vet”, e cila ofron mundësinë e të rinjve të shfrytëzojnë idetë e tyre për krijimin dhe avansimin e tyre në fushën e teknologjisë dhe inovacionit. Njëkohësisht në Komuna e Gjakovës zhvillon aktivitetin edhe Organizata “Jakova Innovation Center”, e cila ofron mundësitë përveç ngritjes së kapaciteteve për të rinjtë e komunës, edhe mundësinë e krijimit të ndërmarrësve të rinjë për zhvillimin ekonomik në komunën e Gjakovës, si dhe inovacionin.

Komuna e Gjakovës, e cila si në infrastrukturë ashtu edhe në kapacitete njerëzore, ofron mundësi të mira për donatorët, që të investojnë në ngritjen e kapaciteteve dhe zhvillimin e të rinjve të komunës së Gjakovës, nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme arsimore, kulturore, rekreative, artistike, muzikore etj.

BAZA LIGJORE

Plani i Veprimit Rinor Komunal 2023-2025 është zhvilluar në përputhje të plotë me Ligjin Nr. 03/L-145 për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë (sipas Nenit 7/pika 1.4 të politikave rinore), ku secila Komunë ka obligim ligjor që të këtë të zhvilluar një Plan të tillë të Veprimit për Rini dhe të aprovuar nga Asambleja përkatëse.

Poashtu, ky Plan përpilohet në harmoni dhe përputhje me Strategjinë dhe Planin Nacional për Rini 2013-2017 të përpiluar nga niveli qendror, respektivisht nga Departamenti i Rinisë, në kuadër të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-145 për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë (sipas Nenit 7/pika 1.4 të politikave rinore), Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e Komunës së Gjakovës, me përkrahje të Zyrës së UNICEF-it në Kosovë, dhe në bashkëpunim me Këshillin e Veprimit Rinor Lokal (KVRL) të Gjakovës si dhe të gjitha OJQ-të dhe spektrin aktivist rinor të Komunës së Gjakovës, ka përpiluar Planin e Veprimit Rinor Lokal tre-vjeçar 2018-2020.

Plani i Veprimit Lokal për Rini 2023-2025, është një dokument i rëndësishëm për sektorin rinor Lokal që aprovohet nga Asambleja Lokale e Komunës së Gjakovës. Plani i Veprimit Rinor Lokal 2023-2025 ka një rëndësi të madhe, si dokument i rëndësishëm i politikë bërjes Lokale në sektorin e rinisë, pasi që shërben si një bazë ligjore për shpërndarje të mjeteve financiare nga Komuna (sipas mundësive buxhetore) e poashtu nga Donatorë të ndryshëm, për aktivitete dhe projekte rinore në Komunën e Gjakovës.

Plani i Veprimit Rinor Lokal është dokument strategjik afatmesëm i Komunës së Gjakovës i cili orienton shërbimet rinore për një periudhë tre vjeçare dhe hartohet nga Sektori i Rinisë pranë Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport në partneritet me Këshillin e Veprimit Rinor Lokal-Gjakovë, dhe me përkrahjen e organizatave ndërkombëtare si UNICEF, GIZ, OSBE, USAID, Caritasi Zvicëran, Caritas Kosova, World Bank, UNDP/UNV, SIDA, Ambasadat në Kosovë, KFOS, KCSF, UNICEF InnovationLab etj.

QËLLIMI DHE KOMPONENTAT KRYESORE TË PLANIT

Qëllimi i Planit të Veprimit Lokal për Rini 2023-2025, si një dokument i rëndësishëm për sektorin rinor Lokal, është që të mundësohet një përkrahje më e madhe për Rininë Gjakovare, në aspektin e edukimit, pjesëmarrjes në vendimarrje, punësimit, dhe rritjes së implementimit të aktiviteteve rinore që kanë rëndësi për zhvillimin dhe edukimin e saj.

Plani i Veprimit Rinor Lokal Gjakovë, i bazuar në Strategjinë Kosovare për Rininë 2023-2025, synon që të përmirësoj gjendjen e të rinjve, duke përfshirë institucionet Lokale Qeveritare dhe jo Qeveritare në identifikimin dhe përmbushjen e nevojave të të rinjve duke gjetur mënyra dhe mekanizma për pjesëmarrjen e të rinjve në procesin e vendimmarrjes në qytetin e Gjakovës.

Plani i Veprimit Rinor Lokal 2023-2025 ka një rëndësi të madhe, si dokument i rëndësishëm i politikëbërjes lokale në sektorin e rinisë, pasi që shërben si një bazë ligjore për alokim të mjeteve financiare nga Komuna e Gjakovës e poashtu nga donatorë të ndryshëm, për aktivitete dhe projekte rinore në Komunën e Gjakovës.

Ky plan përbëhet nga gjashtë (6) komponente kryesore:

- 1) Pjesëmarrja;
- 2) Edukimi jo-formal;
- 3) Punësimi dhe Ndërmarrësia;
- 4) Mjedisi i Sigurtë dhe Edukimi Shëndetësorë;
- 5) Vullnetarizmi dhe Punëtorët Rinorë;
- 6) Integrimi Shoqëror, përfshirja e të rinjve me aftësi të kufizuara dhe të rinjtë e komunitetit jo-shumicë.

Përshkrim i shkurtër i aktiviteteve të parapara për secilën komponentë veç e veç:

1. Pjesëmarrja

Të rinjtë konsiderohen pjesë vitale për zhvillimin e shoqërisë kosovare. Komuna e Gjakovës angazhohet që të përfshijë të rinjtë në proceset vendimmarrëse duke i nxitur të rinjtë dhe duke ju krijuar kushte që të bëhen qytetar aktiv të shoqërisë. Për të ariitur këtë qëllim Komuna e Gjakovës përkrah strukturat dhe mekanizmat rinor dhe organizatat tjera që ndihmojnë në zhvillimin e të rinjve në Komunen e Gjakovës.

Njëri ndër mekanizmat kryesor që ka për qëllim përfaqsimin e të rinjve dhe organizatave rinore është Këshilli i Veprimit Rinor Lokal-Gjakovë (KVRL-Gjakovë), i cili është themeluar me Nëntor 2008 në bazë të Ligjit për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë, Neni 10 dhe Neni 11 si dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 09/2010 për Përgjegjësitë dhe procedurat e themelimit dhe funksionimit të Këshillave të Veprimit Rinor në Kosovë. Që nga themelimi, KVRL-Gjakovë ka mbajtur katër mbledhje të kuvendit të saj me qëllim të zgjedhjes së kryesisë, ndërsa të fundit e ka mbajtur me 23 shtator 2014 ku ka zgjedhur kryetarin, nënkryetarin dhe njëmbëdhjetë anëtar të bordit të KVRL-së. Gjatë procesit të formimit të strukturave të KVRL-së, kryesisë dhe bordit, rëndësi dhe kujdes i veçantë iu është kushtuar aspektit të përfaqësimit gjinor, të personave me aftësi të kufizuara dhe të komuniteteve që jetojnë në komunën e Gjakovës. Puna e KVRL-së është e rregulluar me statut të miratuar nga kuvendi i KVRL-së. Veprimtaria e KVRL-Gjakovë është përkrahur vazhdimisht nga OSCE-ja, GIZ-i, UNICEF-i dhe të tjerë që konkretisht kanë ndihmuar me ngritjen e kapaciteteve të anëtarëve të KVRL-së përmes ofrimit të trajnimeve të ndryshme në ngritjen e kapaciteteve rinore, pjesëmarrjen në seminare dhe kampe rinore. Komuna e Gjakovës gjatë 2018-2020 do të përkrah edhe struktura tjera të cilat kontribuojnë në ngritjen e pjesëmarrjes së të rinjve.

Përfshirja e rinisë, konkretisht angazhimi i KVRL-Gjakovë në mbledhjet e hapura të Kuvendit Komunal rrit pjesëmarrjen publike rinore në proceset vendim-marrëse. Të rinjtë nga KVRL-ja duhet të inkurajohen në harmonizimin e planit e veprimit rinor në baza vjetore duke bashkëpunuar rregullisht me komunën, përkatësisht me drejtorit komunale me qëllim të krijimit të politikave rinore dhe zbatimit të projekteve me interes të përbashkët.

2. Edukimi Jo Formal

Bazuar në hulumtimin e nevojave të rinjve në komunitet, edukimi joformal zë një vend të rëndësishëm në kuadër të edukimit të rinjve të komunës sonë. Mu për këtë arsye në këtë komponentë janë paraparë aktivitete të shumta që ndikojnë në menyrë direkte dhe indirekte në aftsimin dhe ngritjen e kapaciteteve shtesë që të rinjtë i përfitojnë jashtë kurrikules shkollore. Për këtë shkak përmes këtij plani synojmë që ti edukojmë të rinjtë në fusha të ndryshme. Komuna e Gjakovës angazhohet që sistematikisht të ofroj shërbime për ngritjen e kapaciteteve të rinjve.

Gjatë periudhës 2023-2025 do të vendoset një mekanizëm i cili do të ofroj shërbime për ngritjen e kapaciteteve të Rinisë të cilat do të vendosen pas një konsultimi me të gjithë akterët e përfshirë. Këto shërbime deri në momentin kur do të ketë infrastrukturë të mjaftueshme dhe të arritshme për të rinjtë nga secila bashkësi lokale në koordinim të plotë me Drejtorinë e Arsimit do të zhvillohen në shkollat fillore dhe të mesme të komunës. DKRS për këtë periudhë me qëllim që të jetë sa më efikase me resurset ekzistuese do të orientoj ofrimin e këtyre shërbimeve përmes Qendrës Rinore Publike, si dhe duke hapur thirrje për OJQ Rinore të cilat do të ofrojnë programe/aktivitete për edukim Jo-Formal.

Në kuadër të kësaj shtylle të Planit të Veprimit, si më voluminozja në aspektin e aktiviteteve të parapara, parashihet poashtu që të krijohet një bazë e shëndoshë për Punëtorët Rinor që do të mund të aftësohen dhe profilizohen për punën me Rininë, si dhe ngritja e kapaciteteve të rinisë në “soft – skills”, debate dhe tryeza të ndryshme për temat që preokupojnë rininë si dhe organizimin e garava dhe kuizeve të ndryshme të diturisë në shumë lëmi. Në kuadër të kësaj komponente, parashihet poashtu që KVRL-ja dhe Qendra Rinore në Gjakovë të jenë plotësisht funksionale dhe aktive në mënyrë që të mbledh, koordinoj dhe organizoj bashkë me Drejtorinë Komunale për Kulturë, Rini dhe Sport, të gjitha OJQ-të dhe spektrin rinor të Komunës për përkrahje dhe zhvillim më të madh dhe më të efektshëm të Rinisë Gjakovare.

3. Punësimi dhe Ndërmarrësia

Punësimi dhe ndërmarrësia si dy shtylla shumë të rëndësishme për jetën profesionale dhe zhvillimin e Rinisë, paraqitet në këtë Plan me disa aktivitete konkrete që ndikojnë pak a shumë në mënyre direkte ose indirekte në zbutjen e papunësisë në Komunën e Gjakovës. Aktivitete konkrete janë paraparë që të ngriten kapacitetet e rinjve për tu përballur me sfidat e tregut të punës, si dhe për tu përshtatur kritereve dhe aftësive që kërkohen nga tregu i punës.

Është paraparë një hulumtim i tregut të punës dhe aftësive në dispozicion, në mënyrë që të bëhet një analizë e duhur se çfarë ofron tregu dhe atë se çfarë aftësi/kapacitete tek të rinjtë janë në dispozicion, poashtu parashihen organizime të panairëve të ndryshme për promovim dhe zhvillim të kapaciteteve të rinjve, të promovohet puna vullnetare dhe inkurajohen më shumë praktika në institucionet lokale/komunale për të rejtat dhe të rinjtë. Poashtu parashihet të promovohet zhvillimi i ndërmarrësisë dhe krijimit të ndërmarrjeve të

vogla dhe të mesme në mënyrë që të mundësohet krijimi i vendeve të reja të punës. Poashtu parashihen edhe një mori aktivitete që kanë të bëjnë me Qendrën e karrierës dhe të Zanateve për të rinjtë, që do të ndikojnë pozitivisht në ngritjen dhe aftësimin e rinisë për profile të ndryshme profesionale.

Kjo komponentë, është e paraparë në projektin YES (Youth, Employment and Skills), të mbështetur nga GIZ-i Gjerman, e cila përfshin promovimin e punësimit të të rinjve në Komunën e Gjakovës, krijimin e mekanizmave për zhvillimin e kapaciteteve, ngritjen e punësimit, trajnimet nëpërmjet Qendrave e Aftësimi Profesional, si dhe skemën e punës praktike dhe granteve për themelimin e biznesve fillestare. Ky projekt zhvillohet në bashkëpunim me Komunën e Gjakovës, GIZ dhe Ministrinë e Punës dhe Mirëqenjes Sociale, duke u fokusuar në zhvillimin e të rinjve në Komunën e Gjakovës.

Kjo komponentë në Planin e Veprimit Rinor Lokal, është e ndërlidhur me Planin e Veprimit të dalura nga projekti YES dhe i përfshirë në këtë Plan.

4. Mjedisi i Sigurtë dhe Edukimi Shëndetësorë

Është gjithashtu një komponentë e rëndësishme, sepse aktivitete e parapara në Planin e Veprimit 2023-2025 për këtë shtyllë, kanë ndikim shumë të madh në ngritjen e vetëdijësimit të rinisë për dukuritë e rrezikshme dhe fenomenet jo-të shëndetëshme si dhe për promovimin e jetës së shëndoshë tek të rinjtë. Parashihen aktivitete për luftimin e dukurive negative në shkolla (si psh. Kundër përdorimit të substancave narkotike, kundër dhunës në shkolla, kundër përhapjes dhe për mbrotjen ndaj HIV/AIDS-it, etj). Në këtë komponentë parashihen aktivitete vjetore në shënimin e ditëve ndërkombëtare dhe kombëtare lidhur me tema dhe çështje të ndryshme, që ndikojnë në sensibilizimin e të rinjve për ato dukuri që shënohen.

5. Vullnetarizmi dhe Punëtorët Rinorë;

Në kuadër të kësaj komponente, parashihen aktivitete të shumta në promovimin dhe ngritjen e kulturës vullnetare tek të rinjtë në mënyrë që të krijohet dhe zhvillohet rinia edhe më tutje duke marrë pjesë aktivisht dhe në mënyrë vullnetare në aktivitete të ndryshme formale dhe jo-formale. DKRS në bashkëpunim me partnerët lokal dhe ndërkombëtarë do të promovoj dhe stimuloj të rinjtë që të orientohen dhe të kyqen intenzivisht në aktivitete të ndryshme organizuara nga sektori qeveritar dhe jo qeveritar.

6. Integrimi Shoqëror, përfshirja e të rinjëve me aftësi të kufizuara dhe të rinjët e komunitetit jo-shumicë.

Në kuadër të kësaj komponente, parashihen aktivitete të shumta kuturore, artisitke, sportive, shoqërore dhe fushata sensibilizuese në mënyrë që të sigurohet një rritje e integrimit shoqëror, posaçërisht për rininë me aftësi në zhvillim (me nevoja të veçanta), për rininë e zonave rurale dhe për të rinjët e komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian që jetojnë në territorin e Komunës së Gjakovës.

VLERËSIMI I NEVOJAVE PRIORITARE PËR RININË GJAKOVARE

Nevojat më prioritare të parashturara nga të rejat dhe të rinjët Gjakovarë, gjatë punëtorisë kryesore kanë qenë:

1. Rritja e pjesëmarrjes së të rinjëve në proceset e vendimmarrjes, duke përfshirë edhe komunitetet Romë, Ashkali dhe Egjiptian;
2. Përmirësimi i cilësisë së Arsimit duke përfshirë organizimin e garave të ndryshme të dijes dhe lojërave;
3. Punësimi (më shumë mundësi për punësim, praktika me institucionet komunale dhe sektorin privat);
4. Punëtorë Rinor të kualifikuar dhe të trajnuar për të rinjtë;
5. Hapësira dhe objekte të përshtatshme Rinore që mund të përdoren nga të rinjtë pa pagesë;
6. Qasje e përshtatshme, e lehtë, dhe pa pagesë, për të rinjët në infrastrukturën sportive dhe kulturore të Komunës;
7. Qasja në dokumentet publike dhe zyrtare si dhe ngritja e llogaridhënies së institucioneve lokale;
8. Edukimi Shëndetësor dhe promovimi i ngritjes së vetëdijes për sjelljet e rrezikshme tek të rinjtë;
9. Mundësi më të mëdha për programe rinore të shkëmbimeve të përvojave, edukimit dhe praktikave të mira, në nivel nacional dhe regional;
10. Mundësi më të mëdha për Edukim jo-formal të të rinjëve, me më shumë mundësi në dispozicion;
11. Mundësi shtesë për punë vullnetare, që njihet nga institucionet relevante bazuar në Udhëzimin Administrativ të MKRS-së (2010)
12. Financimi i bursave dhe stipendeve shkollore nga Komuna që të përkrahen të rinjtë;

13. Fuqizimi i bashkëpunimit dhe perkrahjes multi-etnike;
14. Fuqizimi i të rinjve nga zonat rurale;
15. Ngritja e perkrahjes për fëmijët dhe rininë aftësi të kufizuara;
16. Mundësi për punë praktike dhe vullnetare për të rinjtë në institucionet komunale, organizatat dhe kompanitë private;
17. Promovimi i integritetit shoqëror dhe barazisë gjinore, të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian;
18. Perkrahja më e madhe për aktivitet sportive dhe kulturore të të rinjve;
19. Kampanja vetëdijësuese kundër sjelljeve të rrezikshme (dhuna, droga, duhani, alkoholi etj) si dhe promovimi i jetës së shëndoshë tek të rinjtë;
20. Promovimi i ditëve nacionale të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptas (si psh 15 Shkurti – dita nacionale e komunitetit Ashkali; 8 Prilli – dita nacionale e komunitetit Romë dhe 24 Qershori – dita nacionale e komunitetit Egjiptas).

MONITORIMI DHE VLERËSIMI I IMPLEMENTIMIT / ZBATIMIT

Implementimi dhe ekzekutimi i Planit të Veprimit Lokal për Rini 2023-2025 do të jetë një detyrë e vazhdueshme për Komunën, sipas mundësive buxhetore si dhe për Donatorët e ndryshëm që veprojnë në Kosovë. Plani i Veprimit 2023-2025, është një udhërrëfyes në aspektin e aktiveteve, për qeverisjen lokale dhe gjithë akterët tjerë potencial që të ndikojnë në ofrimin dhe përmisimin e mëtutjeshëm të shërbimeve dhe mundësive për të rejtat dhe të rinjtë e Komunës së Gjakovës.

Plani i veprimit përfshinë indikatorët e outputit të inkorporuar në matricën e rezultateve, në mënyrë që të shërbejnë si pika shqyrtimi/referimi i progresit dhe implementimit të aktiviteve të paraqitura në Planin e Veprimit.

Institucionet përgjegjëse në nivel lokal që do të jenë përgjegjëse për monitorimin e zbatimit/implementimit të këtij Plani do të jetë DKRS, KVRL-ja dhe një rrjet i OJQ-ve Rinore që do të jenë në gjendje që në baza tremujore, gjashtë-mujore dhe/ose vjetore, të raportojnë konkretisht për nivelin e zbatimit, sfidat dhe vështirësitë e implementimit të Planit të Veprimit Lokal për Rini. Poashtu, të rinjtë bashkë me KVRL në Gjakovë do të organizohen që të jenë pjesëmarrës aktiv në avokim me të gjithë akterët në mënyrë që të sigurohet brenda mundësive maksimale, një implementim sa më i madh dhe i efektshëm i këtij Plani të Veprimit.

Struktura e menaxhimit të implementimit dhe monitorimit të Planit të Veprimit:

Është e rëndësishme që progresi të rishikohet nga Kryetari/ja e Komunës në intervale të rregullta, në bazë të Raporteve dhe informatave që do të jipen nga Komiteti Drejtues i Implementimit të Planit të Veprimit (më tutje “KDIPV”). Kjo strukturë do të përbëhej nga:

- Udhëheqësi i Sektorit për Rini, në DKRS;
- Zyrtarët Rinor pranë DKRS-së;
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa, në Komunën e Gjakovës;
- Përfaqësues nga KVRL-ja në Komunën e Gjakovës;
- Donatorët (GIZ, UNICEF, OSCE, etj);
- Të tjerë sipas nevojës dhe agjendës.

Detyrat kryesore të KDIPV:

- Vlerësojë performancën dhe progresin tremujor, gjashtëmujor dhe vjetor të implementimit të Planit të Veprimit Lokal për Rini;
- Ndan detyra për DKRS-në dhe akterët tjerë relevantë sipas konkluzioneve të progresit të implementimit të Planit të Veprimit;
- Bazuar në planin e veprimit dhe matricën e rezultateve, dhe sipas procedurës së miratuar të punës përcakton informatat e kërkuara sipas indikatorëve (nga plani i veprimit) të agreguara në një matrice logjike dhe të thjeshtë monitorimi;
- Komunikon në baza javore me departamentet dhe agjentët tjerë të identifikuar si bartës aktivitetesh nga plani i veprimit;
- Bën vlerësimin e progresit të implementimit të planit të veprimit në baza mujore;
- Koordinon çfarëdo kërkesë që mund të vijnë nga departamentet apo agjentë tjerë zbatues me Drejtorinë e Kulturës, Rinsë dhe Sportit dhe Drejtoritë tjera të Komunës;
- Mban komunikim të rregullt me të gjithë partneret donatore dhe shoqërinë civile lidhur me implementimin e Planin e Veprimit
- Të tjera të përcaktuara nga KDIPV
- Raportimi i rregullt 2 herë në vit, të Kryetari/ja i/e Komunës.

Organizimi:

- KDIPV mbledhet së paku një herë në tre muaj;
- Organizon së paku një takim vjetor konsultativ me të gjitha palët për performancën e Planit të Veprimit dhe rishikimin vjetor të këtij Plani (e obligueshme).

MATRIKSI I PLANIT TË VEPRIMIT RINOR LOKAL 2023-2025

VËREJTJE ME RËNDËSI PËR BUXHET: NË MOMENTIN E APROVIMIT TË PLANIT TË VEPRIMIT – KUVENDI KOMUNAL DHE ASAMBLEJA KOMUNALE E GJAKOVËS NUK JANË TË OBLIGUARA QË TË KENË NË DISPOZICION BUXHETIN INDIKATIV TË PARAPARË NË KËTË PLAN NË BAZA VJETORE (EDHEPSE KJO DO TE ISHTE SHUMË E DOBISHME) – POR QË NË IMPLEMENTIMIN E KËTJ PLANI DO TË KONTRIBUOJNË FINANCIARISHT DHE ME ASISTENCË TEKNIKE EDHE DONATORËT E NDRYSHËM NË KOSOVË.

Objektivi	Aktivitetet	Rezultatet e pritshme	Institucion-i/et përgjegjëse dhe partnere	Indikatorët (# - Numri; % -Përqindja)	Buxheti			Totali €
					2023	2024	2025	
1. P J E S Ë M A R R J A	1.1 Promovimi i Këshillave të Nxënësve (KN-ve) në shtatë (7) shkollat e mesme të komunës së Gjakovës, organizuar nga DKA dhe KNGJ.	Informimi i nxënësve rreth rolit dhe detyrave të KNGJ-së.		.				
	1.2 Promovimi i punës dhe aktiviteteve rinore nëpër shkolla.	Të rinjët informohen me punën e organizatave rinore dhe mundësive ekzistuese për zhvillim të kapaciteteve.						

	1.3 Funkcionalizimi i Qendrës Rinore të liçencuara dhe KVRL-së si dhe monitorimi i punës së tyre	Krijimi i një komisioni që monitoron dhe vlereson performancën e Qendres Rinore dhe KVRL-së (ku përfshihen dhe aktivist të pavarur						
	1.4 Takime të rregullta tematike me përfaqësues komunal	Përfaqësuesit komunal njoftohen për problematika të ndryshme dhe krijimin e mundësive për intervenim.						
	1.5 Pjesëmarrja e rregullt e anëtarëve të KVRL-së në takimet e hapura të KK Gjakovës/ KVRL.	Ngritja e transparencës komunale dhe qasja me aktive e rinisë në proceset vendimarrëse						
	1.6 Hulumtimi i pjesëmarrjes së rinisë në proceset vendimarrëse dhe aktivitete rinore vullnetare.	Identifikimi me gjendjen aktuale të të rinjëve të përfshirë në proceset vendimarrëse dhe aktivitete vullnetare.						
	1.7 Krijimi i platformës digjitale për sektorin e rinisë.							
	1.8 Pjesëmarrja e rregullt në	Rritja e pjesëmarrjes						

	sesion informues vjetor për rishikimin e buxhetit komunal (qershor) / DKRS, KVRL.	efikase të rinisë						
	1.9 Qendrueshmëria e KVRL-së në Gjakovë	KVRL funksionale, aktive dhe në gjendje që të organizoj në mënyrë të mirëfilltë të gjitha OJQ-të në sektorin rinor të komunës që të ngrisin çështjet që kanë të bëjnë me rininë						
	1.10 Krijimi i klubeve për rinë në zonat rurale	Krijimi i mundësive më të mëdha për të rinjtë në zonat rurale						
2. EDUKIMI JO FORMAL	2.1 Soft skills – batch Ngritja e kapaciteteve tek të rinjtë në “soft skills” (6 muaj çdo vit, trajnime në fusha specifike - tryeza, seminare, workshope etj)	Krijimi i kushteve elementare me përgjegjës aktiv për funksionim të mirëfilltë						
	2.2 Youth workers / Punëtorët Rinor Trajnime për OJQ-të në	Gjakova do të ketë personel të kualifikuar që						

	fushën e punëtorëve rinorë	punojnë në fushën e rinisë						
	2.3 Ngritja e vetëdijes së të rinjëve lidhur me fenomenin e “bulling” (ngacmimet dhe dhunën fizike, emocionale dhe psikike, dhe poashtu të “cyber-bulling”)	Të rinjtë do të ngrisin njohuritë e tyre dhe do të jenë më të informuar për çështjet që i preokupojnë Identifikimi i prioritetëve të veprimeve që mund të inkurajojnë shkollat të zhvillojnë politikat anti-bullying dhe në përgjithësi, strategjitë për të luftuar “bullying” që të përkrahen të rinjtë e shkollave mbështetur nga Personeli i Shkollës, Këshilli i Prindërve dhe Këshilli i Nxënësve.						
	2.4 Kampanjë për vetëdijesimin e të rinjëve kundër diskriminimit dhe barazisë gjinore si dhe kunder paragjykimëve/stigmave të ndryshme	Të rinjtë të vetëdijësuar rreth ngacmimeve dhe me trajnime të ndryshme ata bëhen aktorë pozitivë të avokimit						

		kundër kësaj dukurije në shkolla.						
	2.5 Organizimi i aktiviteteve kulturore dhe sportive me të rinjtë me aftësi të kufizuara dhe aftësi në zhvillim	Të rinjtë me aftësi në zhvillim mund të shprehin dhe të reflektojnë pakënaqësitë sociale dhe do të stimulohen për vetëiniciativë për të sjellë ndryshime pozitive në shoqëri.						
	2.6 Organizimi i kuizeve dhe garave në fushën e ICT për të rinjtë	Ngritja e njohurive dhe testimi i tyre në menyrë që të aktivizohet me shumë rinia						
	2.7 Rritja e programeve të shkëmbimeve arsimore, kulturore, artistike dhe përkrahja më e madhe e Kuvendit komunal	Ofrimi i mundësisë që të rinjtë të mësojnë për kulturat e vendeve tjera dhe të kenë një qasje më gjithëpërfshirëse						
	2.8 Trajnime për të rinjë për zgjidhjet e konfliktit, mediacionin, komunikimin dhe teknikat për ndërmjetësim	Në shoqëri do të promovohet atmosferë e përgjithshme si dhe raporte më tolerante, përmes zhvillimit të metodave alternative						

4. MJED ISI I SIGU		të zgjidhjes së problemeve						
	2.9 Vetëdijesimi i të rinjëve për rëndësinë dhe mundësitë e rrjeteve sociale Ngritja e kapaciteteve e të rinjëve përmes trajnimeve	Të rinjtë e shkollave të mesme në vëdisuar mbi temën lidhur me shfrytëzimin e internetit bazuar në ligjin mbi krimin kibernetikë						
	2.13. Informimi i të rinjve për proceset e intergrimeve evropiane	Të rinjet e informuar dhe të vetëdijesuar për proceset e integritimeve evropiane						
	2.14 Vizita të rregullta me nxenes në objekte kulturore historike	Vetëdijesimi dhe nxitja e të rinjëve për qasje ndaj monumenteve kulturore-historike						
4. MJED ISI I SIGU	4.1 Krijimi i një aplikacioni online të sektorit të rinisë me të dhëna të azhurnuara në kohë reale të organizatave rinore dhe	Aplikacion online funksional dhe i përdorshëm nga institucionet						

	punën e tyre krahas PVRL-së.	komunale KVRL dhe KDIPV						
	4.2 Edukimi i adoleshentëve dhe të rinjëve për ngritjen e vetëdijes për dukuritë negative kundër përdorimit të substancave narkotike, (përmes trajnimeve dhe aktiviteteve të ndryshme artistike). Krijimi i grupeve amatore të artistëve të rinj, shfaqjeve sesioneve informuese, ekspozitave etj. 4.2.1 28 Qershori dita ndërkombëtare kundër narkotikëve	Rritja e nivelit të njohurive tek të rinjtë mbi dëmet e përdorimit të narkotikëve, si dhe mënyra e parandalimit të kësaj dukurie janë krijuar shprehitë e shëndosha Rritja e nivelit të vetëdijes tektë rinjet dhe adoleshentet për pasojat e përdorimit të lëndve narkotike						
	4.3 Edukimi i adoleshentëve dhe të rinjëve për ngritjen e vetëdijes për sëmundjeve seksualisht të transmetueshme, parandalimi isëmundjeve orale, (përmes trajnimeve dhe aktiviteteve të ndryshme artistike). Krijimi i grupeve amatore të artistëve të rinj, shfaqjeve sesioneve informuese, ekspozitave etj.	Rritja e nivelit të njohurive tek të rinjtë mbi dëmet e përdorimit të narkotikëve, si dhe mënyra e parandalimit të kësaj dukurie janë krijuar shprehitë e shëndosha						

	4.4 Edukimi i adoleshentëve dhe të rinjëve për ngritjen e vetëdijes për kundër dhunes në shkolla (përmes trajnimeve dhe aktiviteteve të ndryshme artistike). Krijimi i grupeve amatore të artistëve të rinj, shfaqjeve sesioneve informuese.	Rritja e nivelit të njohurive tek të rinjtë mbi dëmet e përdorimit të dhunës tek të tjerët si dhe mënyra e parandalimit të kësaj dukurie						
	4.5 1 Dhjetori dita ndërkombëtare kundër HIV-AIDS-it	Përmes shënimit të kësaj date do të presim që niveli i njohurive tek të rinjtë rreth kësaj sëmundje të rritet.						
	4.6 Shënimi i ditës ndërkombëtare të Tokës.	Promovimi i rëndësisë se ruajtjes se ambientit, pastrimi i qytetit						
	4.7 Shënimi i ditës ndërkombëtare të Ambientit	Promovimi i rëndësisë se ruajtjes se ambientit, pastrimi i qytetit						
	4.8 Shënimi i ditës ndërkombëtare të Ujit.	Promovimi i rëndësisë se ruajtjes se ujit te pishem						
	4.9 Takime informuese me të rinjtë për Krimin Kibernetik	Të rinjtë janë vetëdijësuar për pasojat e krimeve						

		kibernetike						
	4.10 Kamp veror me të rinjë për ngritjen e aftësive praktike për kujdesin ndaj ambientit dhe zhvillimin e aftësive të të gjeturit në natyrë (Ultimate Survival II) :P	Të rinjët kanë zhvilluar aftësi praktike të kujdesit ndaj ambientit dhe të të gjeturit në natyrë (Skauting babes jauu jauu).						
	4.11 Zbatimi i moduleve të “Shkathtësive për jetën” me nxënësit e klasëve të 8-ta.	Të rinjet janë trajnuar për “Shkathtësive për jetën”						
	4.12 Trajnimi i Këshillit Drejtues (menaxhmentit të shkollës) dhe nxënësve të shkollave fillore dhe të mesme për reagim ndaj rasteve emergjente.	Te rinjet janë ushtruar se të reagojnë në raste të ndonjë vërshimi, termeti apo zjarri.						
5. VULLNETARIETA RIZMI	5.1 Apliki i Udhezimit Administrativ për Pune Vullnetare të të rinjeve, në fuqi nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.	Te gjitha aktivitetet do të kenë prioritet përshirjen e komuniteteve jo-shumice, personat me aftësi të kufizuara, dhe grupet tjera me mundësi të pakta të angazhimit në aktivitete.						
	5.2 Organizimi i kampanjave/sesioneve informuese lidhur me rolin dhe rëndësinë e punës vullnetare tek të rinjet.							

	Informim mbi te drejtat evullnetareve ne baze te Ligjit ne fuqi.	Duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ të MKRS-së (2010), strukturat komunale dhe shoqëria civile do të mundësojnë hartimin dhe zbatimin e platformës për punë vullnetare, me të cilën synohet organizmi rinor dhe promovimi i vlerave si dhe ngjarjeve që janë tërheqëse për rinin duke përfshirë edhe rekrutimin e vullnetarëve të rinj. Planifikimi i aktiviteteve të shërbimit rinor vullnetar dhe aktiviteteve tjera për të rinjtë (UA neni 10.2.9).						
	5.3 Kampanja vetedijesuese per angazhimin e vullnetareve ne qeshtjet ambientaliste.							
	5.4 Aktivitetet per shenimin e Dites Nderkombetare te Vullnetarizmit.							
	5.5 Sesione informuese me institucionet publike per UAPV si dhe me menyren e rekrutimit te vullnetareve sipas UAPV.							
	5.6 Sesione informuese rreth platformes dixhitale www.kosovovolunteers.org , per menyren e regjistrimit te vullnetareve ne platforme.							
	5.7 Aktivitete me vullnetare ne mbrojtjen dhe promovimin e trashegimise kulturore.	Fuqizimi dhe						

		integrim i fuqishëm i të rinjve me nevoja të veçanta dhe të rinjve nga komunitetet jo-shumicë në strukturat dhe aktivitetet rinore.						
	5.8 Organizimi i iniciativës për gara me biçikleta që të tregohet rëndësia e mbrojtjes së ambientit dhe maratona për vrapim.	Aktivizimi më i madh i Rinisë në aspektin sportiv si dhe krijimi i një ambienti më të pastër.						
	5.9 Organizimi i garave në mes të shkollave për mirëmbajtjen e ambientit dhe zgjedhja e 3 shkollave me të mira në këtë drejtim.	Në baza mujore të aktiviteteve të finalizohet me plan veprimi kalendarik në bashkëpunim të DKA dhe DKRS dhe drejtorët e shkollave.						
	5.10 Organizimi i garave në mes të lagjeve bashkësive lokale për mirëmbajtjen e ambientit dhe zgjedhja e 3 lagjeve me të mira në këtë drejtim.	Lagjet do të kenë ambient me të pastër e cila do të ndikoj për një komunë me të pastër						

	5.11 Organizmi i javes per dhurimin e gjakut.	Vullnetaret do te angazhohen ne dhurimin e gjakut.						
	5.12 Integrimi i platformes dixhitale per vullnetare ne Gjakova portal per promovim te punes vullnetare.	Te rinjte e Gjakoves do te kene mundesi per qasje ne patformen per vullnetarizem permes Gjakova Portal.						
	5.13 Kampanja mediale (mediat tradicionale dhe ato sociale) per promovimin e rendesise se punes vullnetare.	Veteditjesimi i te rinjeve dhe rejave per rendesine e vullnetarizimit.						
	5.14 Inkuadrimi dhe informimi i Organizatave dhe te rinjeve ne Sherbimin Evropian te vullnetareve.	Organizatrat dhe te rinjte do te informohen rreth mundesive te angazhimit dhe punes vullnetare ne shtetet evropiane						
	5.15 Organizimi i panairit te vullnetareve ku secili vullnetare ka mundesi te prezantoj punen vullnetare gjate nje viti si dhe shpallja e 3 fituesve si vullnetaret me te angazhuar te vitit.	Vullnetaret do te prezantojne punen e tyre vullnetare te cilen e kane kryer gjate vitit. Poashtu do te shpallen 3 vullnetaret me te angazhuar do te						


		shperblehen per arritjet e tyre gjate vitit.						
	5.16 Mentorimi i tutoreve si vullnetare per ore shtese per nxenesit qe kane veshtiresi ne mesime.	Profesionaliste te ndryshem te lamive te ndryshme do te ofrojne mentorim ne baza vullnetare per nxenesit qe kane veshtiresi ne mesime. Nxenesit do te kene mundesi te marrin ore shtese pa pagese per lendet ku kane veshtiresi.						
6. Integrimi Shoqëror, përfshirja e të rinjëve me aftësi të kufizuara dhe të rinjtë e komunitetit jo-shumicë.	6.1 Aktivizimi i kinemasë dhe hapësirave të pallatit të kulturës (aktivitet avokues në menyrë që kur të nënshkruhet kontrata mes KK dhe Kompanisë të ketë lehtësira për të rinjtë në përgjithësi si dhe po ashtu biletat për të rinjtë 15 - 24 vjeç të kenë zbritje si dhe të ketë infrastrukturë me qasje të përshtatshme për personat me aftësi të kufizuara).	Duke ofruar hapësirat e pallatit të kulturës (dhe kinemasë) duke pas infrastrukturë me qasje te pershtatshme per personat me aftesi te kufizuar .						
	6.2 Krijimi i grupeve letrare	Të rinjtë kanë mundësi që të zhvillohen						

	Dita botërore e Librit	profesionalisht dhe të shënojnë ngjarje me rëndësi në fushën e letërsisë .						
	6.3 Programe promovuese për vlerat kulturore të të rinjve të të gjitha komuniteteve	Të rinjët të informuar mbi vlerat kulturore dhe me promovimin e tyre përmes projekteve me impakt social dhe kulturor . Diversiteti kulturore me të rinjtë me gjithëpërfshirje						
	6.4 Organizim i debateve dhe kuizeve në shkolla duke ngërthyer tema të ndryshme	Socializimi i të rinjëve Testimi i njohurive Zhvillimi i aftësive debatuuese						
	6.5 Fushata për vetëdijësimin e prindërve për rëndësinë e edukimit, shëndetit, sport, kulturës dhe tema të tjera .	Prindërit janë të informuar mbi rëndësinë e edukimit, shëndetit, sportit kulturës etj.						

	6.6 Organizimi i shkollave verore për të gjithë të rinjtë me qëllim të shkëmbimit të përvojave.	Të rinjtë janë informuar dhe vetëdijësuar për eliminimin e paragjytimeve, menaxhimin e konflikteve, rrjetizimin mes tyre për bashkëpunim në lidhje me projekte me ndikim social etj.						
	6.7 Organizimi i ditës / javës së Rinisë me 12 Gusht	Të rinjtë në zona rurale shfrytëzojnë qendrat për zhvillim përmes vullnetarizmit dhe projekteve të ndryshme. Qendrat janë të funksionalizuara për të gjithë të rinjtë që kanë më pak mundësi (mungesa e transportit) në projekte adekuate për ta. Shfrytëzimi i kapaciteteve ekzistuese duke u bazuar në 12 zyre komunale .						

	6.8 Aktivizimi i Qendrave Rinore në zona rurale	Të rinjtë në zona rurale shfrytezojnë qendrat për zhvillim për mes vullnetarizmit dhe projekteve të ndryshme. Qendrat janë të funksionalizuara për të gjithë të rinjtë që kanë më pak mundësi (mungesa e transportit) në projekte adekuate për ta. Shfrytëzimi i kapaciteteve ekzistuese duke u bazuar në 12 zyre komunale .						
	6.9 Organizimi i sesioneve informuese nëpër shkolla për rendësinë e integritetit shoqëror dhe mundësitë e ofruara në inkubatorët multifunksional si "Jakova Innovation Center", "Handikos", "Qendrat e Komunitetit" dhe hapësirën krijuese "BONEVET"	Të rinjtë do të jenë të informuar mbi konceptet dhe vënie në praktikë të integritetit shoqëror dhe mundësive si shërbimeve dhe mbështetje që ofrojnë inkubatorët dhe qendrat multifunksionale për zhvillim profesional						

	6.10 Manifestimi i datave ndërkombëtare për personat me aftësi të kufizuara	Organizimi dhe pjesëmarrja gjithëpërfshirëse e të rinjve me aftësi të kufizuar.						
	6.11 Manifestimi i Datave Zyrtare të të Rinjve nga Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian.	Organizimi dhe pjesëmarrja gjithëpërfshirëse e të rinjve nga Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian.						
	6.12 Nënshkrimi i një Marrëveshjeje të Bashkëpunimit me Komunën dhe OJQ-ve për ofrimin për punë praktike në institucione publike .	Marrëveshja e nënshkruar						
					2023 (€)	2024 (€)	2025 (€)	
				Totali për Vit:				
	<u>Grand Totali për Vitet 2023 – 2024 – 2025:</u>				1			



¹**VËREJTJE ME RËNDËSI PËR BUXHET:** NË MOMENTIN E APROVIMIT TË PLANIT TË VEPRIMIT – KUVENDI KOMUNAL DHE ASAMBLEJA KOMUNALE E GJAKOVËS NUK JANË TË OBLIGUARA QË TË KENË NË DISPOZICION BUXHETIN INDIKATIV TË PARAPARËNË KËTË PLAN NË BAZA VJETORE (EDHEPSE KJO DO TE ISHTE SHUMË E DOBISHME) – POR QË NË IMPLEMENTIMIN E KËTJ PLANI DO TË KONTRIBUOJNË FINANCIARISHT DHE ME ASISTENCË TEKNIKE EDHE DONATORËT E NDRYSHËM NË KOSOVË.

DRAFT